

**RAPORT I AUDITUESIT TE PAVARUR  
DHE  
PASQYRA E FONDEVE TE PERFITUARA DHE SHPENZIMEVE  
TE KRYERA GJATE FUSHATES ZGJEDHORE PER PERIUDHEN  
28 MAJ 2009 - 28 QERSHOR 2009**

Drejtuar :

**Komisionit Qendror te Zgjedhjeve:**

Pallati i Kongreseve ,  
Tirane Albania

Tirane , me 03 Nentor 2009

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkelidhur te fondeve te perfituara dhe shpenzimeve te kryera nga "Partia e te Drejtave te Mohuara- e Re" – P.D.M - RE (e quajtur me tej "Organizate Politike") per periudhen 28 Maj 2009 deri me 28 Qershor 2009.

Pergjegjesia e Drejtimit per Pasqyrat Financiare

Drejtimi mban pergjegjesi per pergatitjen dhe paraqitjen e sinqerte te ketyre pasqyrave ne perputhje me Ligjin Nr. 10019, date 29.12.2008 "Kodi zgjedhor i Republikes se Shqiperise" dhe Ligjin Nr.9228 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" date 29.04.2004. Kjo pergjegjesi perfshin: dokumentacionin mbartes te fondeve dhe shpenzimeve te kryera, politiken kontabel te ndjekur per hartimin e pasqyrave financiare per fondet e perfituara dhe shpenzimeve te realizuara per fushaten zgjedhore, zbatimin dhe mbajtjen e kontrollit te brendshem te pershtatshem per pergatitjen e pasqyrave financiare qe mos permbajne anomali dhe gabime materiale. Mbi kete baze, fondet e perfituara njihen kur fitohen ne lek ose ne materiale dhe sherbime te konvertuara dhe shpenzimet njihen si te tilla ne momentin qe ato jane kryer dhe jo kur ato paguhen.

Pergjegjesia e Audituesit

Pergjegjesia e jone eshte qe bazuar ne auditimin e kryer, te shprehim nje opinion mbi keto pasqyra financiare. Auditimin e kemi kryer ne pajtim me Standartet Nderkombetare te Auditimit. Keto standarte kerkojne qe ne te jemi ne perputhje me kerkesat e etikes dhe qe te planifikohet dhe te kryhet auditimi per te marre sigurine e arsyeshme qe pasqyrat financiare nuk permbajne anomali dhe gabime materiale.

Nje auditim perfshin kryerjen e procedurave, mbi bazen e testeve, te fakteve qe mbeshtesin shumat dhe deklarimet ne pasqyrat financiare. Keto procedura te cilat zgjidhen ne varesi te gjykimit te audituesit, perfshijne vleresimin e rrezikut te gabimeve materiale te pasqyrave financiare, qe mund te kene ndodhur per shkak te mashtrimit ose te gabimeve. Per realizimin e vleresimit te ketyre rreziqeve, audituesi merr ne konsiderate kontrollin e brendshem ne lidhje me pergatitjen dhe paraqitjen e sinqerte te pasqyrave financiare me qellimin qe te hartoje procedura te auditimit te pershtatshme sipas situates, por jo me qellimin e shprehjes se nje opinionit ne lidhje me efektivitetin e kontrollit te brendshem te subjektit. Nje auditim perfshin vleresimin e pershtatshmerise te politikave kontabel te perdoruara dhe arsyeshmerine e vleresimeve kontabel te bera nga drejtimi si dhe vleresimin e paraqitjes se pergjithshme te pasqyrave financiare.

Ne besojme qe evidenca e auditimit qe kemi marre eshte e mjaftueshme dhe e pershtatshme per tu perdorur si baze ne dhenien e opinionit tone te audituesit.

### *Ceshje ne Vemendjen Tuaj*

Ne kerkojme vemendjen tuaj ne lidhje me ,

- a. Shenimi III, paragrafi 4, per evidencen kontabele dhe hartimin e pasqyrave financiare ne pajtim me kerkesat e ligjit 9228, date 29.04.2004 « Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare », si dhe rekomandimin per plotesimin e organikes me nje financier me arsim te larte ose kontraktimin per kryerje sherbime financiare me nje studio kontabiliteti.
- b. Shenimi 2, pikat a dhe b, mbi dokumentacionin mbartes te veprimeve dhe ngjarjeve kontabele dhe kryesisht per ato te shpenzimeve, si dhe rekomandimin per menyren e klasifikimit dhe paraqitjen e shpenzimeve sipas natyres.
- c. Shenimi 3 paragrafi i fundit , per mosçelie te llogarise bankare per fushaten zgjedhore sipas kerkesave te nenit 90, pika 2, e ligjit Nr. 10019, date 29.12.2008 « Kodi zgjedhor ne Republiken e Shqiperise ».

### *Opinion*

Sipas opinionit tone, pasqyrat bashkalidhur , te marra ne teresi dhe ne te gjithe aspektet materiale, pervec ceshtjeve ne vemendjen tuaj persa me siper, japin nje pamje te vertete dhe te sinqerte te fondeve te perfituara dhe nje pamje te pranueshme te shpenzimeve te kryera nga Partia e te Drejtave te Mohuara – e Re , per fushaten zgjedhore ne periudhen 28 Maj 2009 deri ne 28 Qershor 2009, ne perputhje me kohen e perfitimit dhe kryerjes se shpenzimit.

**Ekspert i kontabel i Autorizuar,**

**Lavdimir FUSHA**

Adresa : Rruga "Sami Frasheri", Pall. "Titan Konstruktion",  
prane Drejtorise se Policise Tirane,  
Tirane, Albania

PASQYRA E FONDEVE TE PERFITUARA DHE SHPENZIMEVE TE KRYERA GJATE FUSHATES ZGJEDHORE 2009

Nota	Pershkrimi		Vlera (leke)	%
<b>1</b>	<b>Fondet e marra</b>			
<b>1,1</b>	<b>Nga fondet publike</b>		-	
<b>1,2</b>	<b>Burimet e veta</b>		<b>6.260.000</b>	<b>41,57</b>
<b>1,3</b>	<b>Donacionet e perfituara ne vlere monetare</b>		<b>8.800.000</b>	<b>58,43</b>
1.3.a	Donacionet e perfituara mbi 100 mije leke	209.000		
1.3.b	Donacionet e perfituara nen 100 mije leke	8.591.000		
1.3.c	Donacionet e perfituara ne natyre	-		
	<b>Shuma totale e fondeve te perfituara</b>		<b>15.060.000</b>	<b>100,00</b>
<b>2</b>	<b>Shpenzimet e kryera sipas burimit dhe natyres</b>			
<b>2,1</b>	<b>Shpenzimet e kryera nga burimet e veta</b>		<b>6.260.000</b>	<b>41,57</b>
a	Shpenzime per ambjente te mara me qera	400.000		
b	Shpenzime per postera	1.230.400		
c	Shpenzime per afishe	625.380		
d	Shpenzime per kartela me fotografi	780.520		
e	Shpenzime per gazeten "Lajmetari" & " Drita"	400.000		
f	Shpenzime per udhetime dieta nga selia	483.500		
g	Shpenzime per udhetime dieta per aktivistet	1.920.200		
h	Shpenzime per koktejlle	420.000		
<b>2,2</b>	<b>Shpenzimet e kryera nga donacionet</b>		<b>8.800.000</b>	<b>58,43</b>
a	Shpenzime per konferenca	240.810		
b	Shpenzime per zhvilim mitingjesh	480.960		
c	Shpenzime per transport	390.780		
d	Shpenzime per kancelari	605.220		
e	Shpenzime per udhetime dieta	195.000		
f	Shpenzime per shtabet zgjedhore ne rrethe	5.007.450		
f.1	Shpenzime per udhetime dieta	2.583.500		
f.2	Shpenzime per koktejlle	740.800		
f.3	Shpenzime per trajtim dhe akomodim aktivistesh	1.373.150		
f.4	Shpenzime per telefona	310.000		
g	Shpenzime per shtypshkrime & hapesire publicitare	1.879.780		
	<b>Shuma totale e shpenzimeve te kryera</b>		<b>15.060.000</b>	<b>100,00</b>

## **PARTIA E TE DREJTAVE TE MOHUARA – E RE**

### **Shenime per pasqyrat financiare, lidhur me fondet e perfituara dhe shpenzimet e kryera ne fushaten zgjedhore per kuvendin 2009**

#### **I. Te pergjithshme**

“Partia e te Drejtave te Mohuara – e Re” eshte nje parti me inicialet P.D.M – RE. Eshte nje levizje progresiste e djathte qe ka si qellim kryesor perfaqesimin politik te shtresave dhe grupeve elektorale te te perndjekurve politike e me gjere ne Shqiperi, te cilet nuk jane perfaqesuar deri tani ne spektrin politik.

P.D.M – RE eshte nje parti me vizion pluralist e modelit evropian pa paragjykime fetare, racione apo etnike. P.D.M – RE ushtron veprimtarine e saj politike ne perputhje me Kushtetuten e Shqiperise duke respektuar legjislacionin dhe institucionet e shtetit shqiptar.

#### **Organizimi dhe drejtimi**

Organet Drejtuese te P.D.M – RE ne nivel qendror jane:

Kongresi,  
Keshilli Kombetar;  
Kryesia Kombetare,  
Kryetari,  
Sekretari i Pergjithshem,  
Keshilli i Perhershem,  
Komisioni i kontrollit – revizionit financiar,  
Komisioni i garancive statutore.

#### **Burimet e financiare**

Te ardhurat financiare dhe financimet e Partise mund te sigurohen

Kuotat e Partise.

Sponsorizimet dhe te ardhura te tjera te ligjshme.

#### **Selia, emblema dhe vula**

Selia qendrore eshte perballe parlamentit, ngjitur me lulishten 1 Maji ne rrugen e Elbasanit. Emblema eshte nje fushe e kuqe, me Shqiponjen ne mes, jane dy duar te bashkuaras, lart e shkruar me ngjyre jeshile “PARTIA E TE DREJTAVE TE MOHUARA – e RE”, ndersa poshte eshte 2007. Vula eshte nje imitim i emblemes ne permasa te vogla ne fushe te rumbllaket.

#### **II. Politikat operuese**

Drejtimi i Partise, ka operuar per kete periudhe qe auditojme ne pajtim me Akt-Themelimin dhe statutin e saj, si dhe ne konformitet me objektin e veprimtarise per te cilin eshte krijuar dhe programit te caktuar nga organet qendrore, duke patur ne konsiderat Ligjin Nr. 10019, date 29.12.2008 “Kodi zgjedhor ne Republiken e Shqiperise”, Ligjin Nr. 9228, date 29.04.2004 “Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, si dhe Ligjet fiskale ne fuqi.

### **III. Rregullat e vleresimit**

#### **Menyra e pergatitjes se Pasqyrave Financiare**

Gjendja u pergatit me qellimin per te raportuar tek Komisioni Qendror Zgjedhor , per fondet e perfituara dhe shpenzimet e kryera, gjate fushates zgjedhore 28 Maj deri me 28 Qershor 2009.

Kontabilitetit eshte ndertuar mbi bazen e parimeve te konstatimit. Sipas kesaj menyre fondet e perfituara ne te holla rregjistrohen ne momentin e arketimit te tyre dhe fondet e perfituara ne natyre dhe sherbimet ne momentin e kryerjes duke i konvertuar ne leke me cmimin e tregut dhe shpenzimet pasqyrohen ne momentin e konstatimit te tyre kur jane kryer.

Administrimi i fondeve te perfituara dhe shpenzimeve te kryera eshte bere sipas burimit te fondeve te perfituara dhe detajimi i shpenzimeve kryesisht sipas aktivitetit dhe destinacionit dhe jo sipas natyres se mirefillte. Ky organizim eshte kushtezuar se P.D.M – RE eshte nje force politike e re, eksperiencia e pare ne nje fushate zgjedhore , mungesa e ambjenteve dhe e mjeteve monetare per te patur dhe mbajtur nje strukture organike te plote e te domozdoshme tekniko – ekonomike.

Nga kontrolli dhe verifikimi i kryer mbi evidencen kontabele dhe menyren e pergatitjes se Pasqyrave Financiare u arrit ne perfundimin se ka nevojte per permiresimin e saj ne raport me Ligjin "Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", e cila ka ardhur si pasoje e mungeses se personelit te mirefillte financiar, dhe ne gjykimin tone i rekomandojme drejtimin te Partise, duke patur ne konsiderate dhe burimet financiare plotesimin e kesaj organike me nje ekonomist me kohe te pjesshme ose ndjekjen e sektorit te finances nga nje studio e licensuar ne profesionin e kontabelit te miratuar.

#### **Monedha e raportuar**

Drejtimi financiar i Partise ka perdorur si monedhe baze raportimi monedhen kombetare Leke. Fondet e perfituara dhe shpenzimet e kryera jane mbartur ne dokumentacionin fillestar ne monedhat All. Gjendjet jane pergatitur ne Leke. Fondet dhe shpenzimet e emetuara ne monedha te huaja jane konvertuar ne Leke, bazuar ne kursin e kembimit te dates qe eshte kryer transaksioni.

#### **Taksat dhe Kontributet**

Partia eshte e perjashtuar nga taksat mbi fitimin. Partia i ka shlyer detyrimet qe lindin per Sigurimet Shoqerore dhe Shendetesore te punonjesve dhe per Tatimin mbi te ardhurat personale.

### **1. FONDET E PERFITUARA GJATE FUSHATES ZGJEDHORE 2009.**

#### **1.1 Fondet Publike**

P.D.M – RE , nuk i jane akorduar fonde publike.

#### **1.2. Burime te Veta**

Vene ne dispozicion per fushaten zgjedhore 2009, nga burimet e veta te krijuara nga 08 Janar 2007 deri me 28 Maj 2009. Depozitimi i ketij fondi ne shumen 6 260 000 leke, ne arken e Partise eshte bere pjese pjese me fillimin e fushates sipas nevojave dhe limitit te pranueshem te gjendjes se saj te depozituar ne arke.

### **1.3. Sponsorizimet**

Per fushaten zgjedhore 2009, P.D.M – RE ka perfituar ne formen e dhurimit nga persona fizik e persona juridik vendas shumen prej 8 800 000 leke, nga e cila nen 100 mije leke shuma 8 591 000 leke, dhe mbi 100 mije deri me 1 milion leke ne shumen 209,000 leke. Sponsorizimet nen 100 mije leke per shumen 8 591 000 jana bere nga persona fizik qe kryesisht kane qene kandidat per deputet per Kuvendin 2009. Per sponsorizimet mbi 100 mije leke deri me 1 milion leke, eshte kryer nga Telekomit Shqiptar ne shumen 209 000 leke. Depozitimi i sponsorizimeve ne shumen 8,800,000 leke jane kryer ne llogarine e arkës.

## **2. SHPENZIMET E KRYERA GJATE FUSHATES ZGJEDHORE 2009.**

Totali i shpenzimeve te kryera nga P.D.M - RE, per fushaten zgjedhore 2009 eshte 15,060,000 leke, te cila jane likujduar totalisht ..

Lidhur me shpenzimet e mesiperme, u krye verifikimi dhe kontrolli i plote per te gjitha elementet e mesiperme, dhe u konstatua se:

- a. Jane te mbartura ne teresin e tyre ne dokumentacion, por nje pjese e tyre kerkojne nje rregullesi ne raport me kerkesat e ligjit "Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" si dhe me kerkesat e ligjeve fiskale.
- b. Klasifikimi i tyre dhe paraqitja ne pasqyren financiare sipas burimit te fondeve te perfituara dhe detajimi i shpenzimeve kryesisht sipas aktivitetit dhe destinacionit ne pergjithesi eshte i pranueshem. Por per gjykimin tone duke patur ne konsiderate edhe organizimin dhe drejtimin e forces politike, si dhe per nje administrim me te mire te fondeve, i rekomandojme organizimin dhe klasifikimin e shpenzimeve sipas natyres se tyre.

Bazuar ne menyren e mbajtjes se evidences kontabel, sipas burimit te fondeve te perfituara dhe detajimi i shpenzimeve kryesisht sipas aktivitetit, shpenzimet e kryera gjate fushates zgjedhore jane detajuar :

### **2.1 Shpenzimet e kryera nga burimet veta**

Per shpenzimet e kryera e te ekspozuara ne pasqyren financiare, vlen te japim disa shpjegime te shkurtra per secilin grup, si :

#### **2.1.a Shpenzime per ambjente te marra me qera**

Nisur nga fakti i mungeses se ambjenteve, P.D.M – RE per periudhen Maj 2009 deri me 30 Qershor 2009 , ka marre me qera ambjentet e lokalit prane selise se Partise per shumen 400 000 leke. Ambjenti eshte subjekt i regjistruar ne organin tatimor.

#### **2.1.b,c,d Shpenzime per postera, afise & kartela me fotografi.**

Shpenzimet e mesiperme ne shumen 2 636 300 leke, jane te mbartura ne fatura te leshura per porositesin nga disa shtypshkronja dhe subjekte te tregtimit te kancelarive.

#### **2.1.e Shpenzime per gazetate "Lajmetari" dhe "Drita"**

Pagesa te kryera per botimin e gazetave te mesiperme gjate fushates zgjedhore 2009, ne shumen 400 000 leke.

### **2.1.f, g,h Shpenzime per udhetim e dieta dhe koktejl**

Ne kete grup jane perfshire shpenzimet e kryera per personelin drejtues te partise dhe aktivistet e saj, gjithesej rreth 39 persona. Natyra e shpenzimeve te ketij grupi perbehet, nga transporte, akomodim, trajtim ushqimor, pritje dhe percjellje delegacione si dhe simpatizant te P.D.M - RE .

### **2.2 Shpenzimet e kryera nga fondet e donacioneve**

Ne pergjithesi keto shpenzime jane kryer nga drejtuesit e qarqeve zgjedhore dhe kandidatet e shpallur ne keto qarqe, per aktivitet e zhvilluara .

#### **2.2.a, b Shpenzime per konferenca dhe mitingje**

Per zhvillimin e konferencave dhe mitingje ne rrethe eshte paguar shuma 721 770 leke, e cila perbehet nga shpenzime te natyrave si: salla, kancelari, lajmerime, flamuj , foni e postera.

#### **2.2. c. Shpenzime transporti.**

Shpenzime transporti ne shumen 390 780 leke, perfaqeson shpenzimet per mjete te marra ne perdorim per transport materialesh dhe burimeve njerezore.

#### **2.2. d Shpenzime kancelarie**

Perfaqeson shpenzimet e kryera per kancelari te ndryshme te perdorura gjate fushates zgjedhore nga shtabet e qarqeve neper rrethe.

#### **2.2.e,f, Shpenzime per udhetim e dieta & akomodim, koktejl dhe telefona**

Keto shpenzime jane kryer per drejtuesit e qarqeve zgjedhore dhe kandidatet e shpallur ne keto qarqe ne shumen 5 202 450 leke, per aktivitet e zhvilluara ne keto qarqe dhe natyra e ketyre shpenzimeve eshte kryesisht : transporte, akomodim, trajtim ushqimor, koktejl te bera per simpatizante dhe delegacione si dhe shpenzime komunikacioni.

#### **2.2. g Shpenzime per shtypshkrime dhe hapsira publicitare**

Ky grup shpenzimesh ne shumen 1 879 780 leke, perfshin te gjitha pagesat e kryera per shtypshkrime - si flet palosje, kartela fotografike, postera, reklama si dhe hapesirat publicitare ne mediat e shkruara dhe vizive.

### **3. LIKUJDITETET**

Ne mbyllje te fushates zgjedhore gjendja e likujditeve ne llogarite bankare dhe ne arke, per ato te celura vetem per fushaten eshte 0 leke.

#### **3.1 Gjendja e likuiditeve ne fund te periudhes**

<b>Pershkrimi</b>	<b>Monedha</b>	<b>Kursi</b>	<b>Vlera lek</b>	<b>Vlera usd</b>	<b>Total Lek</b>
Arka	Leke	1	0.00		0.00
Arka	Usd	95		0.00	0.00
Banka	Leke	1	0.00	-	0.00
Banka	Usd	95.00		0.00	0.00
<b>TOTALI</b>			<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>

P.D.M - RE , nuk ka celur llogari bankare sipas kerkeses se nenit nr. 90 pika 2 e ligjit Nr. 10019, date 29.12.2008 . Mos hapja justifikohet nga drejtimi i Parise se nuk parashikonte dhe nuk priste financime mbi 100 mije leke, gje e cila e bente te domozdoshme.

#### **4. KREDITORE TE PALIKUJDUAR**

Nga pasqyra financiare dhe nga verifikimi, nuk rezulton te kete kreditore te papaguar nga furniturat dhe sherbimet e kryera gjate fushates zgjedhore 2009.

#### **5. DOKUMENTACIONI DHE RREGJISTRIMI I FONDEVE JOPUBLIKE**

Rregjistrimi i fondeve jopublike te perfshira gjate fushates zgjedhore 2009 eshte bere ne rregjistrin e posacem, sipas modelit te miratuar me vendim te KQZ-se duke pasqyruar te gjitha shumet e perfituara si dhe te dhena te tjera qe lidhen me identifikim e qarte te dhuruesit. Ne castin e dhurimit, ata kane neneshkruar nje deklarate, ku zotohen se nuk ndodhen ne nje nga rrethanat e percaktuara ne nenin 89 te ketij Kodi dhe mbajne pergjegjesi personale per deklarate te rreme. Forma dhe permbajtja e deklarave te nenshkuara eshte ajo e miratuar nga Komisioni Qendror Zgjedhor, me vendimin Nr. 266, date 01.06.2009, ora 18.00.

Dhurimi i fondeve publike eshte bere ne llogarite e arkes se celur vetem per periudhen e fushates zgjedhore 28 Maj 2009 deri me 28 Qershor 2009.

#### **6. NGJARJE TE MEVONSHME**

Nuk ka patur ngjarje te mevonshme qe mund te influencojne ne pasqyrat financiare te mesiperme.

**Eksperti Kontabel i Autorizuar**

**Nr. License 97, date 10.01.2001**

**Lavdimir FUSHA**